


Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.11.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2788/15, për z. Remzi Mehmeti, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Lipjanit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Remzi Mehmeti, Drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim në Komunën e Lipjanit, Anëtar i Bordit në organizatën joqeveritare Shoqata e Prodhuesve të Qumështit në Kosovë dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtarin e lartë, me këtë rast ai është bindur me fakte për gjendjen e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Zyrtari i lartë z. Mehmeti është njoftuar se gjatë ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë nuk mund të ushtroj funksionin si Anëtar i Bordit në Shoqatën e Prodhuesve të Qumështit në Kosovë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.T.Sh "Bujari", kjo për faktin se Ligji

nr. 04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit publik e ndalon ushtrimin e njëkohësishëm të funksioneve të lartcekura.

Ndërkohë Shoqata e Prodhuesve të Qumështit në Kosovë ka dërguar një shkresë zyrtare në Agjencinë kundër Korrupsionit (DPKI-03-02/3785/15), në të vërtetohet se zyrtari i lartë z. Remzi Mehmeti ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit si Anëtar i Bordit, ndërsa Bordi i Shoqatës ka pranuar dorëheqjen e tij.

Po ashtu, zyrtari i lartë z. Mehmeti ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/3384/15), në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka heq dorë nga funksioni si person i autorizuar në biznesin privat N.T.Sh "Bujari".

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

